



VENDIM

Nr. 35 Datë 06.04.2011

**PËR
MOSFILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ERALD ENERGJITIK” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTIRIKE**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1 dhe 3, neni 16 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.04.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “ERALD ENERGJITIK” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

- Ndryshe nga përcaktimet e Kontratës Koncesionare të datës 16.06.2009, (nenet 2 dhe 3 në të cilat përcaktohet ndërtimi dhe vënia në punë e dy Hec-eve: Hec “Shemri” me fuqi 800 kë dhe Hec “Mgulle” me fuqi 280 kë), shoqëria “ERALD ENERGJITIK” sh.p.k ka paraqitur në ERE aplikimin për liçensim vetëm për Hec “Shemri”, ndërsa për Hec “Mgulle” nuk është paraqitur asnjë dokumentacion.
- Dokumentacioni i Përgjithshëm për Hec- “Mgulle”, neni 9 pikat 1,2,3 dhe 4 nuk është plotësuar.
- Dokumentacioni i Përgjithshëm për Hec- “Shemri”, neni 9 pikat 1,2,3 dhe 4 është plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të mosfillojë procedurat e shqyrtimit të aplikimit për liçensimin e shoqërisë “ERALD ENERGJITIK” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s
NE DETYRE
Entela Shehaj**

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr. __ Datë 06.04.2011

**PËR
MOSFILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ERALD ENERGJITIK” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTIRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____